




Përmbledhje e akteve të cilat e rregullojnë materien vlerësimin e regulativës



Përmbledhje e akteve të cilat e rregullojnë materien vlerësimin e regulativës

Titulli i publikimit

Përmbledhje e akteve të cilat e rregullojnë materien
vlerësimin e regulativës

Botues

Ministria për shoqëri informatike dhe administratë

Redaktorë

Gordana Gapikj Dimitrovska

Tirazhi:

50

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св.
Климент Охридски", Скопје

340.12:35.077.6(497.7)

PËRMBLEDHJE e akteve të cilat e rregullojnë
materien vlerësimin e
regulativës / [redaktorë Gordana Gapikj
Dimitrovska]. - Shkup :
Ministria për shoqëri informatike dhe administratë,
2013. - 47 стр.
; 24 см

Содржи и shtojcë: Raporti i vlerësimit të ndikimit
rregullores

ISBN 978-608-65602-2-5

а) Законодавство - Фактори - Акти за проценка
на влијанието на регулативата - Македонија
COBISS.MK-ID 94751242



British Embassy
Skopje

Ky publikim u mundësua me mbështetje të Ambasadës së Britanisë në kudër të projektit
„Procesi i avancuar rregullator në Maqedoni“ nëpërmjet Qendrës për menaxhim me ndryshime.
Mendimet e paraqitura në këtë publikim janë mendime të autorëve dhe nuk i paraqesin gjithmonë
mendimet e Ambasadës së Britanisë.

METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË RREGULLORES

Në bazë të nenit 20 paragrafi 5 të Rregullores për punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.38/01,98/02, 9/03,47/03, 64/03, 67/03, 51/07, 15/07, 26/07, 30/07, 58/07, 105/07, 116/07, 129/07, 157/07, 29/08, 51/08, 86/08, 114/08, 42/09, 62/09, 141/09, 162/09, 40/10, 83/10, 166/10 172/10, 95/11, 151/11, 170/ 11 dhe 67/13), Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur më 23.07.2013, solli

1. HYRJJE

Metodologjia për vlerësimin të ndikimit të rregullores (në tekstin e mëtutjeshëm: VNR) është tërësisht e harmonizuar me sistemin aktual për planifikimin strategjik në ministritë dhe procedurat për koordinimin e politikave dhe sjelljen e vendimeve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe paraqet përmbushjen të praktikave aktuale të prezentuara në vitin 2009, të cilat njëkohësisht janë të miratuara me eksperiencat pozitive të Bashkimit Evropian dhe vendeve të veta – anëtare, si dhe vendet-anëtare të OECD-së.

Prioritetet Strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë është zmadhimi i rritjes ekonomike dhe rritjen e punësimit e cila realizohet nëpërmjet programeve për implementimin të reformave ekonomike për përmirësimin të biznes klimës si dhe forcimin të konkurrencës në ekonominë maqedone në tregjet shtëpiake dhe botërore. Për atë qëllim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë zbaton sërë masa të drejtuara drejt zvogëlimit të ngarkesave administrative dhe thjeshtëzimin të procedurave, si dhe përmirësimin të kualitetit të rregullores. Këto masa në veçanti janë të drejtuara drejt ndërmarjeve të vogla dhe të mesme sepse

ato paraqesin bartësit të zhvillimit ekonomik në Republikën e Maqedonisë. Masat të drejtuara drejt zvogëlimit të ngarkesave administrative nëpërmjet përmirësimit të kualitetit të rregullores do të kontribuojnë për përmirësimin e konkurrencës së tyre. Proçesi i VNR direkt kontribuon drejt realizimit të qëllimeve të këtyre politikave dhe masave.

Përcaktimi i Qeverisë së Maqedonisë për përparimin e cilësisë të rregullores është e vërtetuar në Strategjinë për reforma të administratës publike si dhe Plani Akcional në të cilat janë të definuara masat dhe aktivitetet për përparimin e cilësisë të rregullores nëpërmjet proçesit të VNR. Nëpërmjet këtij proçesi ministritë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë sigurojnë respektim të parimeve bazë për qeverisje të mirë, dhe atë:

- *Transparitet dhe hapje* –nëpërmjet informimit dhe përfshyrjen e palëve të interesuara në proçesin e tërësishëm –nga hartimi, regullimi dhe deri tek realizimin i politikave dhe ligjeve;
- *Efektiviteti dhe efikasiteti*- arritja e objektivave të dëshiruara nëpërmjet analizës të plotë dhe vlerësimin e ndikimit nga mënyrat e mundshme për zgjedhjen e problemeve (pyetjeve) si dhe gjetjen e zgjidhjes e cila dë t'i arrijë objektivat me shpenzimet më të vogla për buxhetin, subjektet afariste dhe qytetarët;
- *Pajtushmëria* -sigurimin e kornizës të pajtushmërisë të rregulloreve në fushën përkatëse dhe fushat e tjera, si dhe pajtueshmërinë me legjislaturën të Bashkimit Evropian Përgjegjshmëria –transparenca dhe vlerësimi i efikasitetit në implementimin dhe arritjen të objektivave të politikave dhe ligjeve kontribuojnë në rritjen e tërësishme të përgjegjshmërisë në punën e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë.

Proçesi i VNR është veçanërisht i rëndësishëm në kontekst të prioritetit të Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe NATO. Në periudhën para-pranimi, proçesi i harmonizimit të legjislacionit të Republikës së Maqedonisë me Bashkimin Evropian dhe vendet - Anëtare të NATO-s nënkupton analizën realizimin të akteve ligjore të Bashkimit Evropian dhe zhvendosjen e tyre të duhur në legjislacionin nacional. VNR është përdorur si një mjet për vërtetimin e ndikimeve që do të jenë të shkaktuara me implementimin e zhvendosjes të aktit ligjor. Me fillimin e proçesit të negociatave për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian, proçesi i VNR do të merr rëndësi edhe më të madhe për shkak se nëpërmjet tij në një mënyrë të strukturuar mund të vërtetohen efektet afatshkurtra dhe afatgjata të akteve ligjore të Bashkimit Evropian mbi sistemin ligjor nacional dhe mbi pranimin e detyrimeve që dalin nga to. Në këtë mënyrë do të mund të ndërtohen pozicionet nacionale në proçesin e negociatave dhe të vërtetohen dhe zvogëlohen ndikimet e mundshme negative për Republikën e Maqedonisë.

1.1. Qëllimi i Metodologjisë për vlerësimin e ndikimit të rregullores

Целта на оваа методологија е да ги дефинира:

- Procesin i zbatimit të VNR dhe rezultatet e pritura nga procesit i VNR;
- Procesi i përfshirjes i palëve të interesuara.
- Organizimi dhe menaxhimi i procesit të VNR dhe
- Roli dhe detyrat nga secili nga pjesëmarrësit në procesin.

Zbatimi i kësaj metodologjie është e përkrahur nga sistemi informativ dhe atë nëpërmjet e-mbledhjes të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nëpërmjet të Vetmit regjistër elektronik qendror të rregulloreve (në tekstin e mëtutjeshëm: ENER)

1.2. Përfshirja e Metodologjisë

Sipas Rregullores për Punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, VNR implementohet për propozim të ligjeve të cilat dorëzohen deri tek Qeveria e Republikës së Maqedonisë për shqyrtim dhe vërtetim, me përjashtim të ligjeve miratimi i të cilëve propozohet me procedurë urgjente, ligjet për ratifikimin e traktateve ndërkombëtare, ligjet të cilat kryhet harmonizimi terminologjik me ligjet e tjera, propozim Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe Ligji për ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

2. Procesi i Implementimi të vlerësimit të ndikimit të rregullores

Qëllimi kryesor i procesit të VNR është që të sigurojë të mirën informacionet e duhura relevante dhe të sakta në lidhje me ndikimet pozitive dhe negative nga mënyrat e mundshme për zgjidhjen e problemit, si dhe për mënyrën e propozuar arritjen e qëllimit për të cilin propozohet projekt-ligji. Implementimi kualitativ i procesit të VNR kontribuon drejt zbatimin efektiv dhe efikas të ligjit, dhe me atë edhe realizimin të politikave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.


Përmes legjislacionit garantohen parimet themelore të një shoqërie demokratike, respektimin të lirive themelore dhe të drejtave, njëkohësisht po implementohen edhe reforma në shoqëri. Megjithatë, rregullorja nuk është gjithmonë e mënyra e vetme për të arritur qëllimet e dëshiruara. Në disa raste ekzistojnë edhe masa për arritjen e qëllimit, si për shembull kampanjat e informimit dhe trajnim, vetë-rregullimi në disa fusha të caktuara dhe masa të tjera, të njohura si masa joregullatore. Procesi i VNR mundëson parashikimin real të nevojës për zgjedhjen e problemeve rregullatore ose joregullatore.

Procesi i VNR siguron përfshirjen e anëve të interesuara të cilat me informacionet relevante mënyrë të rëndësishme mund të kontribuojnë drejt përparimit të kualitetit të rregullores. Me pjesëmarrjen e palëve të interesuara sigurohen mundësi për zbatimin më të mirë dhe respektimin të rregullatores, ndërsa përsëro publikimi i rezultateve të VNR kontribuon drejt transparencës të procesit rregullator dhe punës të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë.

VNR paraqet pjesën e përpiluar nga procesi i planifikimit, përgatitjes, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe rregullores në ministritë. Procesi i VNR fillon që në fazën e planifikimit strategjik dhe realizohet para përgatitjes të hartim tekstit të rregullores. Më poshtë është paraqitur një përfaqësim skematik i procesit të VNR.

Skema 1: Rishikim i hapave në procesin e VNR

Proces për implementimin të VNR



2.1 Planifikim i procesit për realizimin të VNR

Procesi i planifikimit kryet në kuadër të procesit të planifikimit strategjik i cili zbatohet nëpër ministritë. Sipas Metodologjisë për planifikim strategjik dhe përgatitjen e programit Vjetor për punës të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministritë i planifikojnë programet e tyre duke marrë parasysh prioritetet strategjike të Qeverisë, analizëntë situatave në fushat të cilat janë kompetent, analiza e rezultateve të realizuara, detyrat nga dokumentet strategjike (Plani zhvillimi Nacional, Marrëveshje për stabilizim dhe asocim, Partneriteti për Aderim, programi Nacional për miratimin e së drejtës në Bashkimit Evropian dhe dokumentave të tjera), si dhe qëllimet dhe prioritetet e Ministrisë.

Në bazë të këtyre analizave ministritë i vërtetojnë zgjidhjet e mundshme për problemet ose situatave që cilat kanë qenë të konstatuara gjatë analizës së situatave në fushat të cilat janë kompetente. Në këtë fazë, ministritë i shqyrtojnë mënyrat për zbatimin të zgjidhjeve të mundshme dhe bartin vendime nëse është e nevojshme sjellja e rregullores të re ose ndryshimin e rregullores ekzistuese.

Përderisa në fushën tashmë ekziston ligj ose rregullore tjetër, ndërsa zgjidhjet ekzistuese nuk i japin rezultatet e dëshiruara, ministritë i shqyrtojnë mundësitë për zbatimin e masava joregulative, në vend të ndryshimit të rregullativës ose miratimin e rregullores të re.

Nëse vërtetohet se opsioni më i përshtatshëm për zgjidhjen e problemit është sjellja e rregullores të re ose ndryshimin të rregullores ekzistuese, atëherë kjo iniciativë ndërtohet në propozimin për programin Vjetor për punës të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Për çdo nismë të propozuar, ministritë planifikojnë fonde mjete Fianciare adekuate dhe burime njerëzore të nevojshme për implementimin e rregullores.

Gjatë definimit të iniciativave ministritë parimisht vërtetojnë se si do të jetë shkalla e ndikimeve të mundshme të rregullores së propozuar, të cilat palët e prekura do të jenë të përfshira, çfarë të dhënash do të jenë të nevojshme që të bëhen analizat e nevojshme, si dhe resurset që do të jenë të nevojshme për zbatimin e procesit të VNR.

Planifikimi i implentimit të VNR kryhet në bazë të dispozitës të proporcionalitetit, domethënë sa më shumë është ndikimi i prituri i rregullores së propozuar, aq është më detalisht dhe gjithpërfshirëse VNR e cila duhet të realizohet për propozimin përkatës- rregullativës.

Bazuar në aktivitetet e lartëpërmendura ministritë përgadisin planin Vjetor për implementimin e VNR cila përgatitet paralelisht me përgatitjen e nismave për hartimin e programit Vjetor të punës të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Në Planin Vjetor për realizimin e VNR jepet një pasqyrë e aktiviteteve të nevojshme dhe dinamikën për implementimin të VNR dhe përgatitjen e propozimit të ligjit, rishikimi i palëve të interesuara të cilët do të jenë të përfshira në procesin dhe sigurohet informacioni në kohë për palët e tanguara për përfshirjen e tyre në kohë në procesin. Plani vjetor për implementimin e VNR përmban informacione për

- Titulli i propozim ligjit;
- Përshkrim i shkurtër i problemit;
- Qëllimi i propozimit të ligjit;
- Muaji i dorëzimit të propozim ligjit deri tek Qeveria e Republikës së Maqedonisë (sipas programit Vjetor për punë të Qeverisë);
- Afatet kohore për zbatimin e VNR dhe përgatitja e propozim ligjit;
- Burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e VNR;
- Palët e prekura të cilët do të jenë të përfshira në procesin;
- Mënyra për përfshirjen e palëve të interesuara dhe
- Afatet kohore për zbatimin e konsultimeve.

Ministritë e ndjekin planin Vjetor për implementimin e VNR dhe e azhurojnë në mvarësi nga azhurimi i planit Vjetor për punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Verzinonet azhurorese të planit Vjetor për implementimin e VNR botohen në ENER më së vonë deri më 15 ditë pas miratimit të verzionit azhures të programit Vjetor për punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

2.2. Implementimi i vlerësimit të ndikimit të rregullores

Që të sigurohet realizimi në kohë i procesit të VNR për secilin nga propozimet të ligjit të përmbajtura në Planin Vjetor për implementim të VNR, ministritë duhet të përpilojnë plan dhe dinamikë të aktiviteteve.

Për shkak të informimit në kohë të palëve të interesuara, ministritë jo më vonë se pesë ditë para fillimit të procesit të VNR publikojnë njoftim për fillimin e procesit dhe përgatitje të propozimit të ligjit. Njoftimi publikohet në veb faqen të ministrisë të dhe të Ener-it me informacionet e mëposhtme:

- Emri i ministrisë;
- Emri i propozim ligjit;
- Përshkrim i shkurtër i problemit;
- Qëllimi i propozim ligjit;
- Koha për pregaditjen e propozimit të ligjit;

- Mënyra e përfshirjes të palëve të prekura;
- Njoftim për për inspektim publik dhe debat publik;
- Adresat elektronike të ENER-it dhe veb faqja e Ministrisë të cilët palët e prekura a mund të marrin version elektronik të propozim ligjit dhe hartim Raportin për VNR;
- Adresa Postare dhe / ose adresa elektronike-mail, ku palët e interesuara mund të dorëzojnë mendimet, shënimet dhe sugjerimet;
- Personi përgjegjës për kontakt në ministri dhe
- Informacione të tjera që mund të ndihmojnë për pjesëmarrje efektive të palëve të interesuara në procesin e përgatitjes të propozim ligjit.

Nga ana e ministrive po implementohen hapat e mëtutjeshme gjatë procesit të VNR:

2.2.1 Analiza të situatave, definimit të problemit dhe vërtetimit të objektivave

Në bazë të njohurive nga analiza e situatave gjatë procesit të planifikimit strategjik, ministrinë bëjnë analizë të detajuar të situatave që të shpjegohet thelbi, natyra dhe përfshirja e problemit. Përmes kësaj analize vërtetohen shkaqet që kontribuojnë për ekzistimin e problemit, rregulloret ekzistuese që ndikojnë në problemin dhe lidhshmërinë me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Analiza kryhet në bazë të mbledhjes të të dhënave ose raporte të Ministrisë dhe organeve të tjera të administratës shtetërore, të dhëna nga vetëqeverisja lokale, të dhënat statistikore dhe nëpërmjet kontakteve dhe konsultimeve me palët e interesuara me qëllim që të vërtetohen prova për ekzistimin e problemit.

Në bazë të rezultateve nga analiza përcaktohen qëllimet respektivisht efektet që duhet të arrihen nëpërmjet implementimit të ligjit. Qëllimet duhet të jenë realisht të realizueshme dhe të lidhura me politikat dhe prioritetet e Qeverisë, a përcaktohen sa më konkretisht të jetë e mundur dhe me vlera të matshme. Qëllimet e përcaktuara paraqesin bazë për analizat e mëtejshme gjatë vërtetimit të zgjidhjeve e mundshme dhe masat për arritjen e tyre.

2.2.2. Përcaktimi i zgjedhjeve të mundshme (opcionet)

Pasi që të përcaktohen qëllimet dhe efektet të cilat propozimi i ligjit duhet t'i arrijë, nga ana e ministrive vërtetohen zgjidhjet e mundshme (opcionet), respektivisht nëpërmjet instrumenteve që mund të arrihen qëllimet. Gjatë definimit të zgjidhjeve të mundshme janë shqyrtuar edhe mundësitë për futjen e masave shtesë ose joregulatorë (instrumente) që do të kontribuojnë në zbatimin sa më efikas të implementimin të ligjit në propozim dhe për realizimin e duhur të qëllimeve të përcaktuara.

Ministritë duhet të definojnë së paku tre zgjidhje të mundshme (opsionet) njëri prej të cilëve është “nuk bën asgjë”. Ku me propozim rregullativën duhet të zgjidhen problemet më serioze, kur futen ndryshimeve të mëdha në një fushë të përcaktuar ose ndryshimet do të përfshijnë disa fusha atëherë të shqyrtohen sa më shumë zgjidhje të mundshme (opsione) nëpërmjet kombinimit të masave rregullatore dhe joregullatore (instrumentet).

Si pikënisje në përcaktimin e zgjidhjeve të mundshme (opsioneve) merret opcioni “nuk bën asgjë”. Analiza e këtij opsioni ka për qëllim të tregojë se si gjendja aktuale mund të zhvillohet nëqoftëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë nuk miraton legjislacion adekuat ose nuk fut masa të tjera. Ky opsion ofron bazë për krahasim me zgjidhjet e tjera të mundshme (opsionet).

Në rast kur analizimi i opsionit “nuk bën asgjë”, do të çonte deri tek përfundimi se një problem i caktuar i definuar më parë mund të zgjidhet në mënyrë konsekuente realizimi i rregulloreve aktuale ose nëpërmjet futjes të masave joregullatore, ministria përgatit Informacionin me të cilën tërheq nismën adekuate nga Program vjetor i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me shpjegim për këtë arsye dhe propozon edhe masa të tjera për arritjen të qëllimeve.

2.2.3. Analizën e shpenzimeve, ndikimet dhe përfitimet nga zgjidhjet e mundshme të identifikuar (opsionet) dhe krahasimi i tyre

Gjatë analizës të zgjidhjeve të mundshme të vërtetuara (opsioneve), përdoren metoda të ndryshme dhe mjetet analitike, si për shembull analiza e shpenzimeve dhe përfitimeve, analiza të shpenzimeve dhe efikasitetit, multi – kriteresh analiza, analizë të rreziqeve, modeli i shpenzimeve standarde dhe adekuate. Zgjidhjet e mundshme të vërtetuara duhet të analizohen me përdorimin e metodave të njëjta dhe mjeteve analitike që pastaj mund të krahasohen.

Qëllimi i analizave është të fitohet një pasqyrë e qartë për shpenzimet, ndikimet pozitive dhe negative dhe përfitimet që do të rezultojnë nga secila prej zgjidhjeve të mundshme në mënyrë që të përcaktohet se cili nga opsionet do të çojë deri tek qëllimet e planifikuara me shpenzime minimale (për buxhetin, të subjekteve të biznesit dhe qytetarët) dhe efektet e padëshiruara.

Secili nga mundësitë e vërtetuara mund të shkaktojë lloje të ndryshme dhe nivel të shpenzimeve dhe ndikime të cilat përcaktohen sa më saktësisht të jetë e mundur. Gjatë Analizës duhet të vërtetohen:

- Shpenzimet / përfitimin për buxhetin
- Shpenzimet për subjektet afariste, veçanërisht për ndërmarjet e vogla

dhe të mëdha, grupeve të tjera dhe qytetarëve (në varësi nga ajo se cilit i referohet propozim ligji);

- Ndikimet mbi ekonominë, ndikimet sociale, ndikimet mbi mjedisin hapësinor dhe shëndetin e njerëzve, si dhe lloje të ndryshme ndikimesh në varësi nga fusha;
- Shpenzimet dhe resurset e nevojshme për zbatimin, ndjekjen dhe kontrollin, si dhe vlerësimin e secilës prej zgjedhjeve të mundshme;
- Pranimi / rezistenca që mund të paraqitet gjatë implementimit dhe
- Efektet negative apo të padëshiruara dhe ndikimi.

Në bazë të krahasimit nëmes zgjedhjeve të mundshme të vërtetuara (opsionet), nga ana e ministrisë propozohet zgjedhja e cila sa më efektivisht do të kontribuojë drejt realizimit të qëllimeve të vërtetuara të propozimit ligjit dhe do të arrihen përfitimet me shpenzime sa më të vogla dhe efekte të padëshiruara. Në bazë të zgjedhjes të propozuar pregaditet teksti i propozimit të ligjit.

2.2.4. Planifikimi i mënyrës të realizimit, monitorim dhe vlerësim

Pas kryerjes të analizës të zgjidhjeve të mundshme, (opsionet) konsultimet e bëra me palët e interesuara në përputhje me pikën 4 nga kjo metodologji dhe përgatitja e propozim ligjit, ministritë fillimisht i analizojnë të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zbatimin e zgjidhjes së propozuar të mundur.

Qëllimi është që të jepet një përshkrim i mekanizmave dhe aktiviteteve për implementim, monitorim dhe vlerësim të zgjidhjes të rekomanduar (opcionit) dhe propozim ligjin, gjatë të cilës parimisht vërtetohen:

- Tezat e akteve nënligjore që duhet të miratohen (nëse është e nevojshme) që të zbatohet propozim ligji;
- Mjetet e nevojshme buxhetore për zbatimin të ligjit (sigurim të resurseve njerëzore shtesë, pajisjeve, hapësirave dhe tjetër, nëse është e nevojshme);
- Organet të administratës shtetërore të cilët do të jenë përgjegjëse ose të përfshira në implementimin;
- Aktivitetet që duhet t'i ndërmarë secili nga organet në kuptim të ngritjes të kapaciteteve për implementimin të propozimit të ligjit (edukim dhe trajnime, seminare, drejtime, etj)
- Mënyra e monitorimit dhe indikatorëve për matjen të nivelit të implementimit të masave të parapara me propozim ligjin dhe arritjen e qëllimeve të vërtetuara dhe
- Mekanizmat dhe parimet themelore për vlerësimin të ligjit.

Pas sjelljes të ligjit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Ministritë përgadisin një plan të detajuar për implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e ligjit.

3. PREGADITJA E RAPORTIT PËR VNR

3.1. Qëllimi dhe përmbajtja e Raportit për VNR

Në bazë të analizave të realizuara gjatë procesit të VNR, ministritë përgatisin draft Raportin për VNR (në tekstin e mëtejshëm Raporti). Në Raportin jepet një pasqyrë e procesit dhe rezultateve nga implementimi VNR me qëllim që të mirren informata relevante dhe të sakta në lidhje me ndikimet e mundshme pozitive dhe negative gjatë shqyrtimit të projektligjit dhe sjelljen e konkluzioneve. Raporti ju ndihmon ministrive gjatë përgatitjes të Memorandumit dhe materialeve të cilat e shoqërojnë projekt-ligjin i cili dorëzohet deri në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në pajtim me Rregulloren për punë të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë.

Raporti përgatitet në përputhje me Vendimin për formën dhe përmbajtjen të Raportit për vlerësimin të ndikimit të rregullores. Në draft raportin ministritë japin një pasqyrë të tërë procesit të VNR gjatë së cilës theksohen rezultatet nga analiza e situatave të bëra në fushën e tërësishme gjithëpërfshirëse dhe të fushave të ngjajshme, shqyrtim i zgjidhjeve të mundshme (opsioneve) për zgjidhjen e problemit dhe arttijen e qëllimeve të vërtetuara, analiza e ndikimeve pozitive dhe ndikimeve negative nga aspekti ekonomik, fiskal, aspektin social, ndikimet mbi ambientin mjedisor hapësinor dhe shëndetin e njerëzve, si dhe ndikimeve të tjera në varësi nga fushës e cila rregullohet me propozimin të ligjit.

Në hartim Raportin jepet një pasqyrë e procesit të konsultimeve ku ulen palët e interesuara të cilët kanë marrë pjesë në procesin dhe mënyrën e përfshirjes së tyre, qëndrimet e shprehura gjatë dëgjimeve publike, repektivisht mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e marra në formë të shkruar apo të botuara në ENER dhe portalin E- Demokracia. Në draft Raportin përmenden edhe mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet të cilat kanë qenë të inkorporuara në propozimin të ligjit, si dhe ato të cilët nuk kanë qenë të pranuar nga ana e ministrisë me shpjegim për arsyet.

Hartim Raporti përmban edhe përshkrim të zgjedhjes të rekomanduar përmes të cilit do të arrihen objektivat të projekt ligjit, si dhe mënyrat për implementimin të zgjidhjes të rekomanduar duke përfshirë edhe monitorimin dhe vlerësimin e projekt ligjit.

Në Draft Raportin shkruhet në mënyrë të qartë dhe koncize me përdorimin çka është e mundur terminologjia sa më e thjeshtë që të mund të fitohet një performancë e qartë për të tërë procesin analitik gjatë zbatimit të VNR.

3.2. Sigurimi i mendimit nga Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratës si dhe publikimi i Raportit për VNR

Për shkak marrjes të opinioneve, sugjerimeve dhe propozimeve nga palët e interesuara nga ana e ministrive të ENER-it botohen hartim Raporti dhe teksti i propozim ligjit më së paku deri më dhjetë ditë para dorëzimit të Raportit deri tek Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës.

Nëse hartim Raporti përmban informacione të cilat konsiderohen si informacione të klasifikuara në përputhje me rregullat që kanë të bëjnë me informacionet e klasifikuara, Ministrinë veprojnë në përputhje me të njëjtat dhe nuk e publikojnë hartim-Raportin të ENER. Në mbledhjen e parë të hartim-Raportit në kolonën e duhur shënohet që i njëjti përmban informacione të klasifikuara.

Pas inkorporimit të komenteve relevante nga palët e interesuara, hartim Raporti për VNR, e nënshkruar nga Sekretari Shtetëror i Ministrisë, i dorëzohet Ministrisë për Shoqërisë Informatike dhe Administratës për mendim jo më vonë se 10 ditë nga marrja e draft Raportit për VNR nga ministria kompetente.

Mbas marrjes të mendimit nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës përgatit mendim të paktën dhjetë ditëve nga marrja e draft-raportit për RIA të ministrisë kompetente.

Pas marrjes të mendimit nga Ministrisë për Shoqërisë Informatike dhe Administratës, ministria e përgaditën propozim Raportin të cilin e nënshkruan ministri përgjegjës me të cilën garantohej cilësia dhe saktësia e realizimit të VNR. Së bashku me projekt ligjin ministria e dorëzon projekt-Raportin për VNR dhe materialet e tjera deri tek sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Gjatë vërtetimit të projekt ligjit nga ana e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë dhe marrjes të fragmentit të Hartim procesverbalit të seancës të mbajtur të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministrinë e publikojë Raportin për VNR së bashku me propozim ligjin të ENER-it

4. KONSULTIME ME PALËT E PREKURA

4.1. Qëllimi i konsultimeve

Konsultimet me grupet e interesuara paraqesin pjesën përbërëse të procesit të VNR dhe janë një mekanizëm i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë të rregullores dhe përparimit të efikasitetit dhe efektivitetit në zbatimin e masave të parapara. Konsultimet kontribuojë drejt transparencës më të madhe në punën e Qeverisë dhe procesin i vendimit me të cilën forcohen mekanizmat themelore të demokracisë.

Ministritë duhet të sigurojnë përfshirjen e palëve të interesuara gjatë gjithë procesit të VNR, a në veçanti:

- Në Fazën e analizës të situatave, përkufizimi i problemit dhe vërtetimit të nevojës nga prezantimin e rregullores, konsultimet paraqesin metodë të dobishme për mbledhjen të informacioneve për problemet ekzistuese ose përvojave me implementimin të vlefshmërisë të rregullores;
- Në Fazën e vërtetimit të zgjidhjeve të mundshme (opsioneve) dhe krahasimin e tyre, konsultimet duhet të realizohen pasi që ministria kompetente i ka vërtetuar dhe i ka vendosur themelet për zgjidhjet e mundshme (opcionet). Lëndë e konsultimeve janë opcionet, zbatueshmëria e tyre dhe fizibiliteti si dhe ndikimet e mundshme;
- Në Fazën e vlerësimit të ndikimeve të zgjidhjeve të mundshme të propozuara (opsione), qëllimi i konsultimeve është të vlerësohet saktësia e supozimeve rreth ndikimeve të mundshme, rreziqet, përfitimet dhe efektet.

Ekzistojnë dy grupe të palëve të interesuara dhe atë „të brendshme“ palët e interesuara të cilat përfshijnë ministritë dhe organet e tjera të administratës shtetërore, organizatat administrative dhe organe të tjera qeveritare të cilët kanë kompetencë të ndarë ose interes në propozim rregulloren, dhe „të jashtme“, të cilat bëjnë pjesë subjektet afariste, sindikatat, organizatat joqeveritare, fondacionet dhe shoqatat, grupe të qytetarëve dhe qytetarët të cilët janë të shqetësuar ose të cilët direkt ka të bëjë me projekt rregulloren. Në Varshmëri nga cili grup i palëve të përfshira është kyçur në konsultimet dhe faza në procesin e VNR, aplikohen mënyra të ndryshme të përfshirjes dhe të mbledhjes të mendimeve, sugjerime dhe propozime nga palët e interesuara.

4.2. Metoda e implementimit të konsultimeve me palët e interesuara


Ministritë e planifikojnë përfshirjen e palëve të interesuara që në fazën e planifikimit strategjik dhe përgatitjen e iniciativave të programit Vjetor për punë në Qeverinë dhe përpilimin e planit Vjetor për implementimin e VNR.

Gjatë procesit të VNR, ministritë rregullisht mbledhin opinione nga palët përkatëse të interesuara, a në veçanti në lidhje me zgjidhjet e mundshme (opsione) për zgjidhjen e problemit dhe ndikimet e mundshme, shpenzimet dhe përfitimet nga secili nga zgjidhjet e mundshme.

Gjatë zgjedhjes optimale më të mirë, ministritë e marim parasysh mendimin nga palët e interesuara. Shqyrtim të të gjithë procesit dhe rezultateve nga konsultimet me palët e interesuara jepet në kapitullin e përshtatshëm të Raportit për VNR.

Më poshtë është paraqitur një pamje skematike e afateve në procesin e implementimit të VNR.

Skema 2. Hartimi i procesit të afateve të REA



5. ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I PROCESIT TË REA

Për shak të implementimit kualitativ dhe menaxhimit të procesit të VNR, ministrinë duhet të prezantojnë procedura përkatëse të brendshme dhe të sigurojnë kapacitete për implementimin e mjeteve analitike në korniza të procesit të VNR.

5.1. Organizimi dhe menaxhimi i procesit të VNR në ministrinë

Në varësi nga organizimi i brendshëm i procesit të përgatitjes së ligjeve në ministrinë, procesi i VNR dhe analizat përkatëse po implementohen në kuadër të sektorëve individual në ministrinë të cilat janë përgjegjëse për fushat specifike, respektivisht në kuadër të grupeve punuese të formuara për atë qëllim. Udhëheqësi i sektorit përkatës, respektivisht kryetari i grupit punues, e ndjek dhe siguron implementimin e procesit të VNR që të jetë në përputhshmëri me këtë metodologji me qëllim marrjen sa më e mundur të analizave sa më kualitative dhe Raport për VNR.

Nga ana e Sekretarit shtetëror në Ministrinë përcaktohet mënyra e organizimit të procesit. Sekretari shtetëror në Ministrinë kujdeset për avancimin e vazhdueshëm të procesit të VNR në ministrinë nëpërmjet sigurimit në mënyrë konsekuente në implementimin e vazhdueshëm të procesit dhe të kësaj metodologjie, si dhe nëpërmjet sigurimit të pjesëmarrjes të punësuarve të përfshirë në implementimin të analizave dhe procesit të VNR të trajnimeve të organizuara për atë qëllim.

Që të sigurohet kualitet dhe koordinim i mbrendshëm të procesit si dhe koordinimi me Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratës, në Ministrinë do të përcaktohet dhe emërohet një koordinator për procesin e VNR dhe zëvendësin i tij. Nëpër Ministrinë të cilat kanë kompetenca në më shumë fusha mund të emërohet nga një koordinator për secilën nga fushat dhe zëvendësit e tyre.

Koordinatori për VNR:

- Sigurion mbështetje dhe këshilla të sektorit / grupi punues në lidhje me procesin për implementimin e VNR, analizat e nevojshme, grumbullimin e të dhënave, konsultimet dhe të gjitha hapat në zbatimin e VNR me qëllim në mënyrë të vazhdueshme implementimin e kësaj metodologjie dhe akteve të cilat e rregullojnë materien e cila ka të bëjë me VNR;
- Mbledh informacione dhe bën përgatitjen e planit Vjetor për VNR;
- Ofrimi i këshillave mbi përjashtimet ose ligjet e propozuara që janë subjekt VNR;

- Jep këshilla në lidhje me përjashtimet, respektivisht propozimet të ligjeve të cilat nuk nënshtrohen për VNR
- Jep këshilla gjatë pregaditjes të draft-Raportit për VNR
- Kryen inspektim principalisht të kapitujve të Hartim Raportit dhe tregon, nëse është e nevojshme që të sigurohet zbatim të vazhdueshëm të kësaj metodologjie para hartim Raportit të jetë i dorëzuar deri tek Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës;
- Mbledh të dhëna për përgatitjen të raporteve për implementimin e VNR dhe
- Merr pjesë në trajnimet e organizuara për avancimin e procesit të VNR dhe për rolin e koordinatorit të procesit të VNR në ministri.

5.2. Organizimi dhe menaxhimi i procesit të VNR në Ministrinë për shoqëri in formatike dhe administrates

Pranë zbatimit të procesit të VNR në përgatitjen e propozim ligjeve në fushat për të cilat është kompetente, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës kujdeset për avancimin e procesit të VNR.

Në përputhje me Rregulloren për punë të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë jep mendim për propozimet të ligjeve përgjegjëse për VNR. Mendimi përgatitet në bazë të hartim Raportit për VNR dorëzuar nga ana ministrisë kompetente. Mendimi i Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratës përmban vlerësim për procesin të VNR nga aspekti i pajtueshmërisë të propozim ligjeve me aktet të cilat e rregullojnë materien e cila ka të bëjë me REA.

Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës, me kërkesë të ministrive mund të jep informacione në lidhje zbatimin e procesit të VNR, aktet të cilat e rregullojnë materien e cila ka të bëjë me VNR dhe mjetet analitike për implementimin e VNR. Me qëllim të avancimit të procesit, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës mund të organizojë takime, seminare dhe këshilla me nëpunësat shtetëror të emëruar si koordinatorë për VNR në ministritë. Në bashkëpunim me Sektorin kompetent Sektorin për menaxhim, zhvillimin, koordinimim me resurset njerëzore dhe trajnime në Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratës, organizohen trajnime për nëpunësat shtetëror nga ministritë të cilët janë të përfshira në procesin e pregaditjes të ligjeve dhe implementimin të VNR. Për shkak të sigurimit të konsultimeve efektive me palët e interesuara, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës në vazhdimësi e avancm menaxhimin të proceseve të ENER.

Me qëllim menaxhimin dhe avancimin e procesit të VNR, në Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratës u formua forma organizuese.

6. MONITORIMI DHE PËRPARIMI I PROCESIT DHE METODOLOGJIA

Ministria për shoqëri informatike dhe administrates, në bashkëpunim me ministritë e ndjekën implementimin dhe cilësinë e procesit si dhe metodologjinë për VNR. Në bazë të analizës të hartim Raporteve për VNR të dorëzuara nga ministratë dhe mendimet të dhëna në lidhje me zbatimin e akteve që e rregullojnë materien që ka të bëjë me VNR, nga ana e Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratës në bashkëpunim me ministritë përgatitet raporti Vjetor për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë në lidhje me implementimin dhe përparimin e procesit të VNR.

Që prej ditës të shpalljes të kësaj metodologjie pushon të zbatohet Metodologjia për vlerësimin të ndikimit të rregullores, [“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 66 / 09].

Kjo metodologji botohet në “ Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë “.

UDHËZIM PËR MËNYRËN E PUNËS NË MINISTRITË NË PROCESIN E IMPLEMENTIMIT TË EVALUIMIT TË NDIKIMIT TË REGULLORES

Në bazë të nenit 20 paragrafi (5) nga Rregullorja për punë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë "Gazeta Zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr.38/01, 98/02, 9/03,47/03, 64/03, 67/03, 51/07, 15/07, 26/07, 30/07, 58/07,105/07, 116/07, 129/07, 157/07, 29/08, 51/08, 86/08, 114/08, 42/09, 62/09, 141/09, 162/09, 40/10, 83/10, 166/10, 172/10, 95/11, 151/11, 170/ 11 dhe 67/13), Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur më 23.07.2013, solli

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë udhëzim përshkruhet mënyra e veprimit në punën e ministrive në procesin e implementimit të vlerësimit të ndikimit të rregullores (në tekstin e mëtejshëm VNR).

Neni 2

Procesi i VNR në kuptim të këtij udhëzimi, është një serë aktiviteteve që implementohen analizohen dhe mbledhen të dhënat përkatëse mbi bazë në të cilat zgjedhet zgjedhja më e mirë e problemint gjatë rregullimit të një fushe të përcaktuar dhe për arritjen e objektivave të projekt ligjit në konsultim me palët e interesuara.

Palët e interesuara në kuptim të këtij udhëzimi, janë subjektet afariste, sindikatat, dhomat e tregtisë, shoqatat dhe fondacionet, respektivisht të gjithë personat juridik dhe fizik dhe që mund të preken nga implementimi i ligjit.

2. PLANIFIKIMI I VNR

Neni 3

Planifikimi i VNR bëhet në bazë të parimin të proporcionalitetit, sipas të cilit sa më e madhe është pritja e ndikimi nga propozimi i ligjit atëherë është edhe më e detajuar dhe gjithëpërfshirëse VNR.

Procesi i planifikimit të VNR bashkëvepron me procesin për planifikimin strategjik.

Gjatë planifikimit të VNR, në bazë të analizës të situatave në fushën, definimi i problemit, analizua e regullores ekzistuese dhe implemetnimi i saj dhe konsultimet me palët e interesuara, ministritë përcaktohen për rregullatore ose joregullatore si zgjidhje të mundshme për problemet ose situatave që kanë qenë të konstatuara në fushat të cilat janë përgjegjëse dhe mënyrat për zgjedhjen e tyre.

Neni 4

Gjatë planifikimit të VNR nga ana e Ministrisë përcaktohen:

- Si do të jetë niveli i ndikimeve të mundshme nga propozimi i ligjit,
- Cilët palë të interesuara do të jenë të përfshira,
- Çfarë të dhënash do të jenë të nevojshme që të bëhen analizat e nevojshme, dhe
- Burimet e nevojshme për implementimin e VNR.

Neni 5

Plani Vjetor për implementimn e VNR përgatitet njëkohësisht me përgatitjen e iniciativave për draft programin Vjetor të punës të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Plani Vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të përmban elementet e mëposhtme:

- Titulli i projekt ligjit;
- Përshkrim i shkurtër i problemit;
- Qëllimi i propozim ligjit;
- Muaji i dorëzimit të propozim ligjit për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë (sipas programit Vjetor të punës së Qeverisë të Republikës së Maqedonisë);
- Afatet kohore për implementimin e VNR dhe përgatitja e propozimit të ligjit;

- Burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e VNR;
- Palët e interesuara të cilët do të jenë të përfshira në procesin;
- Mënyrë për përfshirjen e palëve të interesuara dhe
- Afatet kohore për implementimin të konsultimeve;

Formulari i planit Vjetor për implementimin e VNR është dhënë në Shtojcën nr. 1 dhe është një pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi.

Neni 6

Plani vjetor për implementimin e VNR publikohet në regjistrin e Vetëm elektronik nacional të rregulloreve (në tekstin e mëtutjeshëm: ENER) më së voni deri 15 ditë pas miratimit të planit Vjetor për punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Nga ana e ministrive ndjeket dhe azhurohet plani Vjetor për implementim të VNR, sipas monitorimit dhe azhurimit të planit Vjetor për punë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe nevojat për iniciativa jasht nga programi Vjetor për punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Versionet e azhuruara të planit Vjetor për implementimin të VNR publikohen në ENER më së voni 15 ditë mbas miratimit të verzionit të azhuruar të programit Vjetor për punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

3. IMPLEMENTIMI I VNR

Neni 8

Për secilin nga ligjet e propozuara të përmbajtura në planin Vjetor për zbatimin e VNR, përgatitet plan dhe dinamikë për implementimin e aktiviteteve në kuadër të procesit të VNR.

Neni 9

Nga ana e ministrive informohen palët e interesuara jo më vonë se pesë ditë para fillimit të procesit të VNR dhe të përpilimit të propozim ligjit të vërtetuar në planin Vjetor për VNR, nëpërmjet shpalljes të njoftimit të Ener dhe të veb faqes të ministrisë.

Njoftimi në paragrafi 1 nga ky nen duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- Emri i ministrisë;
- Emri i propozim ligjit;
- Përshkrim i shkurtër i problemit;
- Qëllimi i propozim ligjit;
- Afati kohor për përpilimin e propozim ligjit;
- Mënyra e përfshirjes të palëve të interesuara;
- Paralajmërim për inspektim publik dhe debat publik;
- Adresat elektronike nga ENER dhe veb –faqes të Ministrisë të cilët palët e interesuara mund të marrin verzionin elektronik të propozim ligjit dhe draft Raportin për VNR;
- Adresa postar dhe / ose adresën e-mail elektronike, ku palët e interesuara do të mund të dorëzojnë mendimet, shënimet dhe sugjerimet;
- Personi përgjegjës për kontakt në ministri dhe
- Informacione të tjera që mund të ndihmojnë në pjesëmarrjen efektive të palëve të interesuara në procesin e përgatitjes të propozim ligjit.

Formulari për njoftimin nga paragrafi 1 nga ky nen është dhënë në Shtojcën. 2 dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi.

Neni 10

Në Analizën e problemit shpjegohen:

- Thelbi natyra dhe shtrirja e problemit;
- Arsytet që kontribuojnë për ekzistimin e problemit;
- Rregulloret ekzistuese në fusha specifike dhe të ngjajshme;
- Vlerësimi i shkallës së zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve të tjera dhe
- Lidhja me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Neni 11

Në bazë të rezultateve nga analiza e nenit 10 të këtij udhëzuesi, definojnë qëllimet e propozimit të ligjit të cilat duhet të jenë konkrete, të matshme, realiste të arritshme dhe të lidhura me prioritetet strategjike të politikave të Geverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 12

Pas kryerjes të analizës të problemit dhe përcaktimin e objektivave nga ana e Ministrisë vërtetohen zgjidhje të mundshme (opsione) për arritjen e qëllimeve të vërtetuara.

Në varësi të kompleksitetit të problemit, vërtetohen më pak se tre zgjidhje (opsione), njëra prej të cilave është opcioni “nuk bën asgjë”, e cila paraqet bazë për krahasimin me zgjedhjet e tjera (opsione).

Me analizën e opcionit “nuk bën asgjë” vërtetohet si do të kishin qenë pasojat në një fushë të caktuar në qoftë se Qeveria e Republikës së Maqedonisë nuk intervenon nëpërmjet propozimit të ligji apo masave të tjera.

Neni 13

Iniciativa për për sjelljen e propozim ligjit tërhiqet nga programin Vjetor për Punë i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë nëse analiza nga neni 12 nga ky udhëzim vërtetohet që problemi i definuar më parë mund të zgjidhet me zbatimin e duhur të rregulloreve ekzistuese ose nëpërmjet futjes të masave jorregullore.

Tërheqja nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet me informacion nga ministria deri tek Qeveria e Republikës së Maqedonisë në të cilën theksohen arsyet për tërheqjen e iniciativës.

Neni 14

Nga ana e ministrive vërtetohen shpenzimet, përfitimet dhe ndikimet nga aspekti ekonomik, aspektin fiskal dhe social, si dhe nga aspekti i ndikimit mbi hapësinën mjedisore për secilin nga zgjedhjet e mundshme të vërtetuara (opsione) ku përdoren përdoren metoda të duhura dhe mjete analitike.

Nga ana e ministrive bëhet krahasimi nëmes shpenzimeve dhe përfitimeve nga zgjedhjet e mundshme të vërtetuara (opsione) dhe propozohet zgjedhja e cila do të kontribuojë sa më efektive drejt realizimit të qëllimeve të vërtetuara të propozimit të ligjit, në fakt zgjedhjen me të cilën do të arrihet përfitimi me shpenzime më të vogla dhe efekte të padëshirueshme.

Neni 15

Zgjidhja e propozuar nga neni 14 nga ky udhëzuesi inkorporohet në propozimin e ligjit.

Nga ana e ministrive parimisht analizohen të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me implementimin e zgjidhjes së propozuar dhe jep pasqyrë të përgjithshme të mehanizmave dhe aktiviteteve për implementimin, monitorimin dhe evaluimin të zgjedhjes të rekomnduar në fakt të propozim ligjit.

Nga ana e ministrive përgatitet një plan i detajuar për implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e ligjit pas sjelljes të ligjit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 16

Në fund të implementimit të VNR, hartohet draft Raporti për VNR. Draft raporti për VNR përmban një revizion të analizave të implemtuara analizat dhe konsultimet e bëra me palët e interesuara gjatë të gjithë procesit të VNR.

Neni 17

Draft Raporti për VNR dhe propozimi i ligjit publikohet në Ener dhe në veb-faqen e Ministrisë së paku 10 ditë para dorëzimit të draft Raportit për VNR deri tek Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës.

Përderisa draft Raporti për VNR përmban informacione që konsiderohen si informacione të klasifikuara, draft Raport për VNR nuk publikohet në ENER dhe ekzistenca e informacioneve të klasifikuara shënohet në kolonën përkatëse të faqes së parë të draft Raportit përVNR.

Neni 18

Draft Raporti për VNR, nënshkruar nga sekretari shtetëror i ministrisë dorëzohet në mendim deri tek Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës. Pas marrjes së mendimit nga Ministria për shoqëri informatike dhe administratës, përgatitet propozim Raport për VNR, të cilën e nënshkruan ministri përkatës.

Neni 19

Propozimi i ligjit dhe propozim Raporti për VNR së bashku me materialet e tjera, dorëzohen deri tek Sekretariati e Përgjithshëm i Qeverisë të Republikës së Maqedonisë.

Neni 20

Pas vërtetimit të propozim ligjit nga ana e Qeverisë dhe marrjen e fragmentit nga Plan procesverbali nga mbledhja e mbajtur e Qeverisë së Rewpublikës së Maqedonisë, Raporti për VNR së bashku me propozimin e ligjit publikohet në ENER.

4. KONSULTIME ME PALËT E INTERESUARA

Neni 21

Varësisht nga përmbajtja e propozimit të ligjit dhe ndikimeve të mundshme (ekonomike, sociale dhe hapësirës mjedisore) nga ana e ministrive vërtetohen palët e interesuara që duhet të jenë të përfshira ose të konsultuara në procesin e implementimit të VNR dhe përgaditjen e propozim ligjit.

Përfshirja e palëve të interesuara sigurohet gjatë të gjithë procesit, duke filluar prej fazës të planifikimit, implementimi i procesit të VNR dhe përgaditjen e propozim ligjit.

Neni 22

Me palët e interesuara bëhen konsultime: sipas propozimit të ligjit, për çështje të caktuara, për zgjidhje të mundshme (opsione), ose për vërtetimin të ndikimeve nga propozimi i ligjit.

Në varësi nga ndikimet e pritshme të propozim ligjit, përcaktohen një ose më shumë mënyra për përfshirjen dhe konsultimeve me palët e interesuara. Konsultimet me palët e interesuara mund të kryhen në disa nga mënyrat e mëposhtme:

- Shqyrtim publik i propozim ligjit;
- Dëgjime publike;
- Kërkesë për mendimet e shkruara, shënimet dhe sugjerime nga palët e interesuara;
- Pjesëmarrjen në grupet punuese të formuara nga Ministria ose Qeveria e Republikës së Maqedonisë;
- Mbledhje me palët e interesuara;
- Debatet publike mbi çështje të caktuara përmes përdorimit të mjeteve elektronike interaktive në dispozicion të portaleve Ener dhe E-demokracia.

Neni 23

Me qëllim të konsultimeve strukturore dhe efektive me palët e interesuara, nga ana e ministrive mund të përgatisin pyetje, përkatësisht tema në të cilat do të mbahet diskutimi ose mblidhen mendimet, shënimet dhe sugjerimet. Pyetjet, përkatësisht temat nga paragrafi 1 i këtij neni formulohen në një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, të kuptueshme për të gjithë palët e interesuara.

Neni 24

Nga ana e ministrive mund të mbahet një dëgjim publik gjatë procesit të implementimit të VNR dhe përgaditjen të propozim ligjit.

Për shkak të mbajtjes të dëgjimit publik, propozimi i ligjit vendoset në inspektim publik dhe lëshohet thirrje për inspektim publik.

Në thirrjen nga paragrafi 2 të këtij neni theksohen:

- Titulli i propozim ligjit
- Koha fillestare dhe përfundimtare e inspektimit publik,
- Vendi, respektivisht adresa URL adresa e Ener dhe veb faqen e internetit të ministrisë, ku palët e interesuara mund të bëjnë inspektim publik dhe
- Data e mbajtjes së dëgjimit publik.

Thirrja për inspektimin publik të Ener dhe veb faqen të Ministrisë

Në varësi nga kompleksiteti i pyetjeve të cilat të rregullohen me propozim ligj nga ana ministrive përcaktohet afati për implementimin e inspektimit publik i cili nuk do të jetë më i shkurtër se 15 ditë.

Dëgjimi publik mbahet pas afatit të fundit për inspektimin publik.

Nga ana e ministrive, më pak se pesë ditë para dëgjimit publik, dorëzohen ftesa deri tek palët e interesuara për të marrë pjesë në dëgjimin publik me shkrim dhe / ose e-mail postës elektronike dhe nëpërmjet publikimit të ftesës të Ener dhe veb faqen e ministrisë.

Neni 25

Nga procesin i implementuar të konsultimeve me grupet e interesit, në Raportin për VNR vendosen:

- Informacionet për mënyrën e përfshirjes të palëve të interesuara;
- Të dhënat për palët e interesuara të cilat kanë participuar në procesin;
- Pikëpamjet e shprehura gjatë diskutimeve publike, respektivisht mendimet, shënimet dhe sugjerimet e marra me anë të shkrimit ose të publikuara Ener dhe portalin dhe E-demokracia;
- Mendimet, shënimet dhe sugjerimet të cilat kanë qenë të inkorporuara në propozimin e ligjit dhe
- Mendimet, shënimet dhe sugjerimet të cilat nuk u pranuan nga Ministria dhe arsyetimi për shkaqet.

5. DISPOZITAT MBYLLËSE

Neni 26

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzuesi ndalon të vlejë Udhëzimi për mënyrën e veprimit në punën e ministrive për përfshirjen të palëve të interesuara në procedurën për përgatijen e ligjeve (“Gazeta Zyrtare në Republikën e Maqedonisë” nr. 150/11).

Neni 27

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën tjetër pas ditës të botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

MINISTRIA E ...

PLANI VJETOR PËR ZBATIMIN E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT TË RREGULLORES PËR VITIN _____

[illegible]

UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN TË PLANIT VJETOR PËR IMPLEMENTIMIN TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT TË RREGULLORES

1. Emri i propozim ligjit:

(Vendosen titulljt të çdo propozim ligji sipas rendit të paraprë në programin Vjetor për punë në Qeveri)

2. Përshkrim i shkurtër i problemit:

(Vendoset një përshkrimi shkurtër i problemit respektivisht shkaqet përshak të cilave propozohet propozim ligji).

3. Qëllimi i propozim ligjit:

(Vendoset qëllimi apo qëllimet që projekt ligji duhet t'i arrijë).

4. Muaji i dorëzimit të propozim ligji deri tek Qeveria

(Vendoset muaji kur propozim ligji do të dorëzohet deri tek Qeveria sipas programin Vjetor për punë të Qeverisë).

5. Korniza kohore për implementimin e VNR dhe përgaditjen të propozim ligjit;

(Vendosen datat ose periudha kur planifikohet të fillojë dhe të mbarojë procesi i implementimit të VNR dhe përgatitjen të projekt-ligjit).

6. Resurset e nevojshme njerëzore dhe financiare për implementimne VNR

(Vendosen burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare që do të jenë të nevojshme për implementimin e VNR).

7 Palët e interesuara të cilët do të jenë të përfshirë në procesin

(Vendosen palët e interesuara të cilat kanë qenë të vrtetuara në procesin të planifikimit dhe të cilët do të jenë të përfshirë në procesin të konsultimeve).

8. Mënyra e përfshirjes të palëve të interesuara

(Vendosen mënyrat e zgjedhura të përfshirjes të palëve të interesuar me qëllim që të sigurohet pjesëmarrja e tyre efektive në procesine VNR dhe përgatitjen e propozim ligjit).

9. Afati kohor për implementimn të konsultimeve

(Vendoset periudha kur planifikohet të fillojë dhe të mbarojë procesi i konsultimeve me palët e e interesuara).

SHTOJCA NR. 2

NJOFTIM PËR FILLIM TË PROCESIT PËR PËRGADITJEN TË PROPOZIM LIGJIT

Titulli i ministrisë		
Titulli i propozim ligjit		
Spjegim i shkurtër i problemit		
Qëllimi i propozim ligjit		
Korniza kohore për pregaditjen e propozim ligjit		
Mënyra përfshirjes të palëve të interesuara		
Pralajmërim për inspektim publik dhe debat publik	Po	Jo
Adresa elektronike ku palët e interesuara do të mund të ndërmarin verzionin elektronik të propozim ligjit dhe draft Raportin për VNR		
Adresa dhe /ose adresa elektronike ku mund të dorëzohen mendimet, vërejtjet dhe sygjerimet		
Personi përgjegjës për kontakt në Ministri		
Informacione të tjera		

UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E NJOFTIMIT PËR FILLIMIN TË PROCESIT PËR PREGADITJEN E PROPOZIM LIGJIT

1. Titulli i ministrisë

(Vendoset titulli e ministrisë)

2. Titulli i propozim ligjit

(Vendoset titulli i propozim ligjit)

3. Përshkrim i shkurtër i problemit

(Vendoset përshkrim i shkurtër i problemit, respektivisht arsyet për shak të cilëve propozohet sjellja e e projekt-ligjit).

4. Qëllimi i propozim ligjit

(Vendoset qëllimi apo qëllimet të propozim ligjit)

5. Korniza kohore për përgatitjen e propozim ligjit

(Vendoset periudha e fillimit dhe mbarimit të procesit të VNR dhe përpunimin të propozim ligjit sipas planit Vjetor për implementimin të VNR).

6. Mënyra e përfshirjes të palëve të interesuara

(Vendoset mënyra e zgjedhur ose mënyrat e përfshirjes të palëve të interesuara).

7. Paralajmërim për inspektim publik dhe debatin publik

(Shënohet PO përderisa planifikohet inspektimi publik dhe debati publik, ose JO përderisa nuk planifikohet inspektimi publik dhe debati publik).

8. Adresat elektronike ENER dhe veb -faqja e Ministrisë të cilët palët e interesuara mund të ndërmarin versionin elektronik të propozim ligjit dhe draft-Raportit për VNR

(Vendosen adresat elektronike të ENER dhe veb -faqja e ministrisë ku palët e interesuara mund ta marrin propozimin e ligjit dhe Draft Raportin për VNR).

9. Adresa postare dhe / ose adresa elektronike të cilat palët e interesuara mund të dorëzojnë mendimet, shënimet dhe sugjerimet

(Vendoset adresa postare dhe / ose adresa elektronike, ku palët e interesuara mund t'i paraqesin opinionet e tyre, shënimet dhe sugjerimet).

10. Personi përgjegjës në ministri dhe adresa elektronike për kontakt

(Vendoset emri dhe mbiemri i personit përgjegjës në ministri i cili emërohet si personi për kontakt në lidhje me konsultimet me palët e interesuara dhe adresa e tij elektronike).

11. Informacione të tjera

(Vendosen informacione të tjera që mund të ndihmojnë për pjesëmarrje efektive të palëve të interesuara në përgatitjen e procesit të propozim ligjit).

VENDIM

PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E RAPORTIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË RREGULLORES

Në bazë të nenit 66 paragrafi (3) nga Rregullorja për punë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" бр. 38/01, 98/02, 9/03, 47/03, 64/03, 67/03, 51/06, 5/07, 15/07, 26/07, 30/07, 58/07, 105/07, 116/07, 129/07, 157/07, 29/08, 51/08, 86/08, 114/08, 42/09, 62/09, 141/09, 162/09, 40/10, 83/10, 166/10, 172/10, 95/11, 151/11, 170/11 и 67/13), Qeveria e Republikës së Maqedonisë më vitin 23.07.2013, solli

Neni 1

Me këtë Vendim përshkruhet forma dhe përmbajtja e Rregullores për Vlerësimin të ndikimit të rregullores (në tekstin e mëtejme: Raporti VNR).

Neni 2

Raporti për VNR përmban mbikqyrje të analizave të implementara gjatë procesit të evaluimit të rregullores nga ana e ministrive.

Raporti për VNR pregaditet në formë të formularit: "Raport për vlerësimin e ndikimit të rregullores", e cila përmban: titulli i ministrisë, titulli i propozim ligjit, personi përgjegjës dhe kontakt informacionet, lloj i Raportit, detyrim për përgatitjen e propozim ligjit, lidhshmëri me direktivat e Bashkimit Evropian, a përmban draft Raporti informacione sipas rregulloreve që kanë të bëjnë me informacionet e klasifikuara, data e publikimit të draft Raportit të Vetëm nacional regjistri elektronik i rregulloreve, data e dorëzimit të draft Raportit deri tek Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës data e marrjes të mendimin nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratës dhe afati i dorëzimit të propozim ligjit deri tek sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Raporti për VNR përmban dhe:

1. Përshkrim i situatave në fushën dhe definimin të problemit;
2. Objektivat të rregullores së propozuar;
3. Zgjidhjet e mundshme (opsionet);
4. Vlerësimi i ndikimit të rregullores;
5. Konsultimet;
6. Konkluzione dhe zgjidhje e rekomanduar;
7. Implementimi i zgjedhjes së rekomanduar dhe
8. Monitorimi dhe vlerësimi.

Raporti për VNR përmban dhe deklaratë nga Sekretari Shtetëror dhe deklarata e ministrit.

Formulari i Raportit për VNR është i dhënë në shtojcë dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Me datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi ndalon të vlejë Vendimi për formën dhe përmbajtjen e formularëve për vlerësimin të ndikimit të rregullores («Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë» nr. 66/09).

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën tjetër pas botimit në „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“.

Nr.
— viti 2013
Shkup

Kryetar
i Qeverisë së
Republikës të Maqedonisë

SHTOJCË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT RREGULLORES

Titulli i ministrisë:

Titulli i propozimit të ligjit:

Personi përgjegjës dhe kontakt
informacione:

Lloj i Raportit

- ☐ Draft
☐ Propozim

Detyrimi për përgaditjen të
propozimit të ligjit rrjedh nga:

- ☐ Plani vjetor për punë e Qeverisë së Republikës së
Maqedonisë
☐ PNAA
☐ Konkludim i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë
☐ Tjetër _____

Lidhshmëria me Direktivat të BE

A përmban draft Raporti
informacione sipas rregulloreve
që kanë të bëjnë me
informacionet e klasifikuara

- ☐ Po
☐ Jo

Data e publikimit të draft Raportit
të ENER

Data e dorëzimit të draft Raportit
deri tek Ministria për Shoqëri
Informatike dhe administratës:

Data e marrjes të mendimin nga
Ministria për Shoqëri Informatike
dhe Administratës:

Afati për dorëzimin të propozim
ligjit deri tek ekretariati i
Përgjithshëm

1. Përshkrimi i situatave në fushat dhe definimin të problemit

1.1 Përshkrim i situatave

1.2 Arsytet për problemet të cilat janë lëndë për shqyrtim

2. Objektivat e propozim rregullores

3. Zgjidhjet e mundshme (opsionet)

3.1 Përshkrimi i zgjidhjes “nuk bën asgjë”

3.2 Përshkrimi i zgjidhjeve të mundshme (opsionet) për zgjidhjen e problemit

4. Vlerësimi i ndikimit të rregullores

Ndikimet e mundshme pozitive dhe negative të secilës prej opsioneve:

4.1 Ndikimet ekonomike

4.2 Ndikimet fiskale

4.3 Ndikimet sociale

4.4 Ndikimet mbi ambientin mjedisor

4.5 Ndikimet administrative dhe shpenzimet -

a) shpenzimet për imlementim

b) shpenzimet për respektimin të rregullores

5. Konsultimet

5.1 Palët e interesuara dhe mënyra e përfshirjes

5.2 Revizion të mendimeve të marra dhe të inkorporuara

5.3 Mendimet të cilat nuk janë marrë parasysh dhe pse

6. Konkluzione dhe zgjidhje të rekomanduar

6.1 Shyrtim krahasues i ndikimeve pozitive dhe negative të zgjidhjeve të mundshme (opsionet)

6.2 Rreziqet në zbatimin dhe aplikimin të secilës nga zgjidhjet e mundshme (opsionet)

6.3 Zgjidhja të rekomanduar me shpjegim

7. Implementimi i zgjedhjes së rekomanduar

7.1 Nevoja për ndryshim të ligjeve dhe rregullores nënligjore në fushën ose fusha të tjera të ngjajshme

7.2 Aktet nënligjore të nevojshme dhe afat për miratimin e tyre

7.3 Organe të administratës shtetërore, organet shtetërore dhe organet kompetente për implementim

7.4 Aktivitete për sigurimin të implementimit efektiv të propozimit të ligjit

8. Monitorimi dhe vlerësimi

8.1 Metoda për monitorimin dhe implementimin

8.2 Vlerësimi i efekteve nga propozim i ligjit dhe afatet

Deklaratë nga Sekretari Shtetëror

Draft Raporti për vlerësimin e ndikimit të rregullores është i përgatitur në përputhje me Metodologjinë për vlerësim e ndikimit të rregullores. Ai siguron një vlerësim real të ndikimeve të mundshme dhe efektet e pritura, si dhe shpenzimet e lidhura me secilën prej zgjidhjeve të mundshme të identifikuara (opsione) për të zgjidhur problemin

Nënshkrim i sekretarit shtetëror

Data: _____

Raporti i Ministrit

Në bazë të rezultateve nga analizat të treguara në Raportin për vlerësimin të ndikimit të rregullores mendoj që zgjidhja e rekomanduar (opsioni) paraqet mënzrën më të mirë për zgjidhjen të problemit dhe arritjen e efekteve të dëshirushme në mënyrë sa më ekonomike.

Nënshkrim i ministrit

Data: _____

UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E RAPORT PËR VLERËSIMIT E NDIKIMIT TË RREGULLORES

Titulli i ministrisë:	Ka të bëjë me titullin e ministrisë
Titulli i propozimit të ligjit:	Ka të bëjë me titullin të propozimit të ligjit
Personi përgjegjës dhe kontakt informacione:	Ka të bëjë me emrin mbiemrin dhe informacionet për kontakt të udhëheqësit të sektorit respektivisht kryetari i grupit punues i obliguar për implementimin të VNR për propozimin konkret të ligjit
Lloji i Raportit	☐ Hartim – shënohet “hartim” kur ministria kompetente e dorëzon hartim raportin për VNR deri tek Ministria për shoqëri informatiek dhe administratës për mendim.Hartim Raportin e nënshkruan sekretari shtetëror i ministrisë. ☐ Propozim – shënohet “propozim” kur ministria kompetente e dorëzon propozim Raportin deri tek sekretariati Gjeneral i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.Kur ministria përgjegjëse e dorëzon propozimin. Propozim Raportin e nënshkruan ministri
Detyrimi për pregaditjen e propozimit të ligjit rrjedh nga:	☐ Shënohet përgjigja e zgjedhur ☐ Plani vjetor për punë i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ☐ NPAA Konkluzion i Qeverisë të Republikës së Maqedonisë ☐ Tjetër _____
Lidhshmëria me Direktivat të BE	Përderisa më lartë është shënuar përgjegja NPAA, përmendet Direktiva konkrete /dhe me të cilën krzhet miratimi
A përmban hartim raporti informacione sipas rregullores që kanë të bëjnë me informacionet e klasifikuara	Shënohet përgjegja e zgjedhur ☐ Po ☐ Jo

Data e shpalljes të hartim Raportit në ENER:	Theksohet data e shpalljes të hartim Raportit në ENER
Data e dorëzimit të hartim Raportit deri tek Ministria për shoqëri informatike dhe administratës:	Theksohet data e dorëzimit të hartim Raportit deri tek Ministria për shoqëri informatike dhe administratës
Ministria për shoqëri informatike dhe administratës:	Theksohet data e marrjes të mendimit nga Ministria për shoqëri informatike dhe administratës
Afati për dorëzimin të propozim të ligjit deri tek sekretariati Gjeneral	Theksohet data /afati i dorëzimit të propozimit të ligjit deri tek Sekretariati Gjeneral

1. Përshkrimi i situatave në fushën dhe definimin të problemit

1.1 Përshkrimi i situatave

(Jepet përshkrimi i situatave në sferën duke përfshirë edhe regullativëm valide në fushën apo fusha të tjera të lidhura, si dhe programe të tjera / projekte të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë)

1.2 Arsyet për problemet të cilat janë në shqyrtim

(Shpjegohen arsyet për problemet të cilat janë lëndë për shqyrtim (jo vetëm simptomat)

2. Objektivat e propozim rregullore

(Përmenden qëllimet e pritura / qëllimet e dëshiruara dhe efektet të cilat rregullorja e propozuar duhet t'i arrijë)

3. Zgjidhje të mundshme (opsionet)

3.1 Përshkrimi i zgjidhjes “nuk bën asgjë”

(Shpjegohet situata “nuk bën asgjë”, respektivisht jepet një përshkrim i pasojave përderisa Qeveria e Republikës së Maqedonisë nuk intervenon për propozimin e ligjit, ose masë tjetër)

3.2 Përshkrimi i zgjidhjeve të mundshme (opsionet) përzgjidhjen të problemit

(Theksohen zgjidhjet e mundshme (opsionet) për zgjidhjen e problemit që kanë qenë të konsideruara gjatë procesit të VNR. Pastaj, theksohet përmbajtja e opsioneve dhe mënyra për implementimin e zgjidhjeve të mundshme, respektivisht nëpërmjet miratimit të ligji të ri, ndryshimin dhe plotësimin e ligjit (masat rregullore), të trajnimeve, fushatave dhe aktiviteteve të ngjajshme (masat joregullore) ose kombinim i masave (rregullore dhe joregullore).

4. Vlerësimin e ndikimit të rregullores

4.1 Ndikimet ekonomike

(Përshkruhen përfitimet dhe shpenzimet për ekonominë në sferën, punësimit dhe dhe konkurrencës. Veçanërisht duhet të përshkruhen ndikimet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, subjekteve ekonomike, konsumatoreve, familjeve, etj.)

4.2 Ndikimet fiskale

(Përshkruhen shpenzimet dhe fitimi i buxhetit, rishikim i iniciativave shpenzimeve të projektuara, si dhe informacion mbi faktin a janë të siguruara mejtet në buxhetin (jepet një rezymë nga Formulari për ndikimet fiskale).

4.3 Ndikimet sociale

(Përshkruhen ndikimet mbi uljen e varfërisë, mbrojtjen dhe përparimin e shëndetit, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut dhe barazive gjinore, mbrojtja e grupeve të rrezikuara dhe të dëmtuara, etj.)

4.4 Ndikimet mbi mjedisin hapësinor

(Përshkruhen ndikimet mbi cilësinë e ajrit, ujit, tokës, gazeve serë, zhurma, bio-diversitetit, etj., Jepet përshkrim si ndikon në hapësirën mjedisore direkt ose indirekt mbi shëndetin e njerëzve)

4.5 Ndikimet administrative dhe harxhimet-

a) shpenzimet për zbatim

(Përmenden shpenzimet për zbatimin të propozim ligjit – krijimin e institucioneve të reja/ organeve apo zgjerimin e përgjegjësisë dhe organizimin e organeve ekzistuese, resurseve të nevojshme njerëzore dhe trajnimin e tyre, investicionet (hapësirë për zyre), vëzhgim i nevojshëm, pajisje, etj.)

b) shpenzimet për respektimin të rregullores

(Theksohen shpenzimet për respektimin të rregullores - futjen e ngarkesave të reja administrative, formalitetet dhe shpenzimet (licencat, lejet, informacionet, standardet) për personat juridik dhe / apo fizik dhe se si ajo do të ndikojë mbi konkurrencën)

5. Konsultimet

5.1 Palët e interesuara dhe mënzra e përfshirjes

(Theksohen palët e interesuara që kanë qenë të konsultuara gjatë procesit të mënyrave dhe konsultimin e tyre / përfshirjen)

5.2 Shqzrtim i mendimeve të marra dhe të inkuorpuara

(Jepet një përshkrim i mendimeve të marra me theks të veçantë në atyre pyetjeve të cilat kanë shkaktuar interesim të veçantë ose shqetësim tek palët e interesuara. Theksojmë cilat mendime kanë qenë të marra parasysh)

5.3 Mendimet të cilat nuk janë marrë parasysh dhe pse

(Theksohen se mendimet që nuk janë marrë parasysh dhe me arsyetimin për shkaqet për atë)

6. Konkluzionet dhe zgjidhja e rekomanduar

- 6.1 Shqartim krahasues të ndikimeve pozitive dhe negative të zgjidhjeve të mundshme (opcione)
(Jepet përshkrim krahasues të anëve pozitive dhe negative ose ndikimi të vendimeve të mundshme (opcione)
- 6.2. Reziqet për zbatimin dhe implementimin të çdo zhgjedhje të mundshme (opcione)
(përshkruhen reziqet për zbatimin dhe imeplementimin të çdo vendim të mundshëm (opcione)
- 6.3 Vendim i rekomanduar me arsyetim
(përshkruhet vendimi i rekomanduar me arsyetim për çka rekomandohet)

7.Zbatim i vendimit të rekomanduar

- 7.1. Nevoja për ndryshimin e ligjit dhe regullativës nëligjore në fusha ose në fusha tjera të njëjta
(Theksohet vallë vendimi i rekomanduar do të paraqes nevojë për ndryshim të ligjeve dhe regullativave nëligjore në fushat ose fushat e tjera të njëjta)
- 7.2. Aktet nëligjore të nevojshme dhe afati i aprovimit të tyre
(Theksojmë vallë cilat nën ligje duhet të miratohen dhe afati i caktuar për aprovimin e tyre)
- 7.3 Organet nga drejtoria shtetërore, organet shtetërore dhe organet e tjera kompetente për zbatimin
(Theksohen organet e drejtorisë shtetërore organet shtetërore dhe organet e tjera që do të jenë komepetente për zbatimin)
- 7.4. Aktivitete për sigurimin dhe zbatimin efikas të propozim ligjit
(Theksohen aktivitetet (masat joregullative) të cilat dë të ndërmiren me qëllim të sigurimit dhe zbatimit efikas të propozim ligjit (trajnime, këshilla, kampanja, etj)

8.Monitorimi dhe evaluimi

- 8.1 Mënyra e monitorimit të implementimit
(Pëshkruhet shkurtimisht si do të përcillet zbatimi dhe arritja efektive nga regullorja dhe cilat organe të drejtorisë shtetërore do të kyçenn në porcesin e monitorimit)
- 8.2. Evaluacioni i efekteve nga propozimi i ligjit dhe afatet
(Përshkruhet shkurtimisht si do të kryhet evaluacioni nga efektet nga regullorja dhe në cilin periudhë kohore)

Raport nga Sekretari Shtetëror

Hartim Raporti për vlerësimin të ndikimit të regullores është i pregaditur në pajtushmëri me Metodologjinë për vlerësim të ndikimit të regullores. Ai jep një vlerësim real të ndikimeve të mundshme dhe efekteve të pritura, si dhe shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me çdo zgjidhje të mundshme të vërtetuar (opcionet) për zgjidhjen e problemit.

Nënshkrim i sekretarit shtetëror

Data: _____

(Sekretari shtetëror e nënshkruan raportin në hartim Raportin para ministrisë përkatëse t'a dorëzojë hartim Raportin për VNR deri tek Ministria për shoqëri informatike dhe administratës për mendim).

Raporti i Ministrit

Në bazë të rezultateve nga analizat të treguara në Raportin për vlerësimin të ndikimit të regullores mendoj që zgjidhja e rekomanduar (opcionit) paraqet mënyrën më të mirë për zgjidhjen të problemit dhe arritjen e efekteve të dëshirushme në mënyrë sa më ekonomike.

Nënshkrim i ministrit

Data: _____

(Ministri i ministrisë përkatëse e nënshkruan deklaratën në propozim Raportin para se ministrisa kompetente t'a dorëzojë propozim Raportin deri tek Sekretariati Gjeneral të Republikës së Maqedonisë).